

VENDIM
Nr.795, datë 27.11.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE TË CRANS MONTANA FORUM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 32 000 000 (tridhjetë e dy milionë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për organizimin e veprimtarive të Crans Montana Forum, që do të zhvillohen jashtë shtetit dhe në Shqipëri, në maj të vitit 2007, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe këtij Forumi.

2. Ky fond të përballohet nga pjesa e papërdorur e fondeve, të dhëna me vendimin nr.67, datë 9.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përzgjedhjen e shoqërisë, që do të bëjë kontrollin e procedurave dhe të ligjshmërisë së kontratës për privatizimin e “Albtelecom” sh.a.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha